



Informacione për vaksinimin kundër COVID-19

Vaksinimi kundër COVID-19 është i rekomanduar sipas autoriteteve të shëndetësisë federale dhe kantonale për 3 arsye :

- 1. Vaksinimi mbronë personat të rrezikuar dhe zvogëlon numrin e rastëve të rënda dhe të vdekjeve.**
- 2. Vaksinimi zvogëlon numrin e të shtrirëve në spital, dhe mundëson funksionimin e sistemit shëndetësor për të gjithë.**
- 3. Vaksinimi mundëson luftën kundër shkaqëve sociale dhe ekonomike negative të pandemisë.**


Përse është e rëndësishme të behet vaksinimi kundër COVID-19 ?

Infeksioni nga koronavirusi (SARS-CoV-2) shkakton më së shpeshti një formë të lehtë të COVID-19 të të rriturit dhe të fëmijët. Sëmundja është më e rëndë te të moshuarit dhe te personat që vuajnë nga sëmundje tjera (obezitet, diabet, hipertension, sëmundje të zemrës ose të mushkërive, kancer, sëmundje ose terapi immunosupresive). COVID-i-19 mundet të shkaktoj komplikime dhe në disa raste kërkohet mjekim intensiv në spital për një kohë të gjatë. COVID-i-19 mund të jetë vdekjeprurës. Te personat që janë të shëruar gjithashtu COVID-i-19 mund të shkaktojë probleme shëndetësore për një kohë të gjatë. Dhe për këtë arsye është e rëndësishme të bëhet vaksinimi.

Cilat janë vaksinat ? Si veprojnë ato ?

Zvicra ka zgjedhur t'i ofroj popullatës vaksinat të prodhuar nga firmat Pfizer/BioNTech dhe Moderna. Disa studime janë realizuar dhe kanë vërtetuar që këto vaksina janë më shumë efektive. Vaksinat Pfizer/BioNTech kanë qenë të miratuar nga organet e kontrollës Swissmedic më 19 dhjetor 2020.

Kjo vaksinë përmbanë një pjesë të kodit gjenetik të koronavirusit, i quajtur ARN-informativ. Kodi ARN është i rrethuar me pika të vogla të dhjamit. ARN-i informativ i komandon qelizat të prodhojnë një proteinë që i përngjan mbështjellësit të koronavirusit. Sistemi imunitar pastaj e njeh këtë proteinë dhe do të krijoj antitropa kundër koronavirusit. Në rast të infektimit, do të mund ta eliminojë shpejt virusin. ARN-informativ i injektuar me vaksinën është automatikisht i shkatërruar pas 1-2 ditë dhe zhduket tërësisht nga trupi ynë.



Burimi i fotografisë : Infovac 22.12.2020

Qka vërteton sigurinë dhe efikasitetin e kësaj vaksine të re ?

Disa studime janë bërë për të testuar sigurinë dhe efikasitetin e vaskinave. Këto studime duhet të rrespektojnë standardet ndërkombëtare. Ato janë kryer në shtete të ndryshme dhe mijëra persona kanë pranuar të marrin pjesë.

Këto studime kanë ndihmuar :

- për të kontrolluar që vaksinat nuk kanë efekte të dëmshme për shëndetin (siguri);
- për të vërtetuar që vaksinat mbrojnë kundra sëmundjës të COVID-it-19 (efikasitet): Për 100 persona të vaksinuar me dy doza, 95 prej tyre kanë shmangur infeksionin kur kanë qenë në kontakt me virusin dhe 5 personat që kanë qenë të infektuar, kanë zhvilluar vetëm një formë të lehtë të sëmundjes.

Organi i kontrollës Swissmedic ka miratuar këtë vaksinë në bazen e këtyre studimeve. Dy doza nevojiten të merrren me një muaj diferencë.

Cilat janë rreziqet e kësaj vaksine të re ?

Kjo vaksinë nuk mundet të shkaktoj COVID-in-19. Si shumica e vaskinave, kjo vaksinë e re mund të ketë efekte të padëshirueshme të lehta. Këto efekte ndodhin ditën e vaskinimit apo të nesërmen. Ato janë për shembull:

- dhimbje në vendin e vaskinimit
- lodhje
- dhimbje koke
- ngurtësi e muskujve
- tjera reaksione inflamatorë të lidhura me aktivizimin e sistemit imunitar.

Këto reagues janë normale dhe jo të rrezikshme. Ato zgjasin prej 1 deri në 3 ditë. Mund të jenë të zvogëluara me marrjen e Paracetamol-it dhe nuk nevojitet kujdes mjekësor.

Efektet e padëshirueshme serioze janë shumë të rralla, për shembull një reagues alergjik me vaksinën. Këto reagues janë të lehta për t'u trajtuar.

Për kë është vaksina e rekomanduar më së pari ?

Vaskinimi rekomandohet së pari për popullatën me rrezikshmeri më të lartë të komplikimeve në rast të infektimit :

- personat mbi moshën 65 vjeç ;
- personat të prekur me sëmundje tjera (obezitet, diabet, hipertension, sëmundje të zemrës ose të mushkërive, kancer, sëmundje ose terapi immunosupresive).

Pjesa tjetër e popullatës mund të vaskinohet më vonë, kur të ketë më shumë vaksina në dispozicion. Fëmijët dhe adoleshentët janë për momentin të përjashtuar nga vaskinimi për dy arsye :

- informacionet mbi sigurinë e vaksines të fëmijët dhe adoleshentët nuk janë ende të njohura;
- nuk zhvillojnë forma të rënda të sëmundjes.

Për cilet persona vakcina nuk është e udhëzuar ?

Disa persona nuk duhet të vaksinohen (është e kundër-indikuar). Këta persona janë :

- personat që kanë pasur ndonjë herë një reaktion alergjik të rëndë me një vaksinë ose me një nga përbërësit ;
- gratë shtatzëna sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për efektet në shtatzëni.

Disa persona duhet të presin para se të vaksinohen. Ata janë :

- personat që kanë pasur COVID-in-19 para pak kohe. Është e rekomanduar të presin tre muaj pas fillimit të simptomëve për tu vaksinuar;
- personat që kanë një sëmundje akute (temperaturë, ethe, etj).

Sa kohë mbronë vakcina kundër COVID-it-19 ?

Mbrojtja kundër COVID-it-19 fillon dy javë pas injektimit të parë. Është maksimale një javë pas injektimit të dytë.

Ende nuk e njohim kohëzgjatjen e mbrojtjes. Mund të jetë disa muaj ose disa vite. Do të vlerësohet më mirë efikasiteti i vaksinës kur do të testohet në një numër më të madh të personave. Përsëritja e vaksinës mund të jetë e nevojshme pas 1, 2, 3, 5 ose 10 vitëve.

Sa kushton vaksinimi kundër COVID-19 ?

Vaksinimi kundër COVID-19 është falas. Kostot do të merrën për sipër nga sigurimi shëndetësor (pa franchise), nga kantonët dhe nga Konfederata. Vaksinimi nuk i nënshtrohet as franchisës e as përqindjes (quote-part).

Kur dhe ku mund të vaksinohemi ?

Personat në rrezik, d.m.th. personat mbi moshën 65 vjeç (fillimisht : mbi moshën 75 vjeç) do të kontaktohen për vaksinat e para. Si të mirrën vaksinat me sasi më të madhe, vaksinimi do të përhapet edhe nëpër grupet tjera. Disa qendra do të hapën së shpejti.

Ministria federale e shëndetit publik, Komisioni federal për vaksinime, mjekët kantonal, shoqatat zvicerane të mjekëve dhe specialistëve ju rekomandojnë të vaksinoheni. Mos hezitoni të diskutoni këtë me mjekun tuaj.

Për më shumë informata

Ndiqni të gjitha informatat në faqën www.ge.ch ose shikoni www.infovac.ch ose www.ofsp-coronavirus.ch/vaccination

Po ashtu mund të **thirrni në 0800 909 400** për të shtruar pyetjet tuaja.